



Prishtinë, 22.03.2024
Kodi i ZRRE-së: V_1882_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Rregullës Per Kushtet e Përgjithshme te Furnizimit me Energji;
- Metodologjinë e Taksave te Kycjes të Rrjetit te shpërndarjes;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_2507_03_24** i dt.13.03.2024;

në seancën e mbajtur më datë 22.03.2024 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** ankesa e konsumatorit **XH.K "INTEREX"** nga Komuna e Prishtinës si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II. KEDS** duhet të bëjë shkyçjen e konsumatorëve me shifrat DPR – 2003881; DPR – 90039450; DPR – 90042942; DPR – 90066517; DPR90100126 dhe DPR – 90127482 nga TS-Interex me kod 10012181047000.
- III. KEDS** duhet që brenda periudhës tre mujore të bëjë kyçjen e këtyre konsumatorëve në asetet e veta dhe me shpenzime të Operatorit të Shpërndarjes
- IV.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- V.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 31.10.2023 ka parashtruar ankese kundër KESCO dhe KEDS për mos shkyçjen e konsumatorëve të kyçur/furnizuar përmes TS të tij privat DPR – 2003881; DPR – 90039450; DPR – 90042942; DPR – 90066517; DPR90100126 dhe DPR – 90127482

- Me datë 30.12.2022 konsumatori XH.K ka bërë kërkesë zyrtare në KESCO dhe KEDS për shkyçjen e konsumatorëve me shifrat DPR – 2003881; DPR – 90039450; DPR – 90042942; DPR – 90066517; DPR90100126 dhe DPR – 90127482 nga TS i tij privat.

Provë: Kërkesa për shkyçjen e konsumatorëve nr. 13808 datë 30.12.2022



- Me datë 31.10.2023 konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke parashtruar ankesë kundër KESCO dhe KEDS për mos shqyrtimin e konsumatorëve shifrat DPR – 2003881; DPR – 90039450; DPR – 90042942; DPR – 90066517; DPR90100126 dhe DPR – 90127482 nga TS i tij privat sipas kërkesës së tij.

Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 31.10.2023

Bordi i ZRRE, duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEDS-it/KESCO, ka vërejtur se:

Bazuar në dokumentacionin të ofruar nga konsumatori XH.K vërtetohet se KEK sha me datë 13.01.2004 bazuar në kërkesën e aplikuesit XH.K ka lëshuar PEE nr.03/17 për ndërtimin TS me fuqi 250 kVA 11.10.2004 për fuqi maksimale të njëkohshme prej Pm_{nj}=120 kW. Me datë 11.10.2004 bazuar në kërkesën e aplikuesit XH.K KEK sha Divizioni i Rrjetit ka lëshuar Aneks për Pëlqim Parimor me Nr.969 për objektin Depos-Hipermarket me fuqi maksimale të njëkohshme prej Pm_{nj}=450 kW. Në PEE e lëshuar po ashtu është evidentuar se furnizimi i Depos-Hipermarket me energji elektrike duhet të bëhet nga Trafostacioni që do të ndërtohet nga aplikuesi, S_n=630 kVA si dhe kyçja bëhet në nivel të Tensionit 10(20) kV. Bazuar në transaksionet e konsumatorit si dhe rrjedhën e energjisë elektrike konstatohet se konsumatori i është bërë pranimi teknik dhe se me datë 29.12.2004 i është hapur shifra DPR-90037446.

Bordi i ZRRE ka analizuar shifrat e konsumatorëve të cilët furnizohen përmes TS-Interex me kod 10012181047000 dhe konstaton se shifrat DPR – 2003881; DPR – 90039450; DPR – 90042942; DPR – 90066517; DPR-90100126 dhe DPR – 90127482 janë hapur në periudha të ndryshme. Shifra DPR-2003881 është hapur me datë 10.03.2008, shifra DPR-90039450 me datë 08.06.2005, shifra DPR-90042942 me datë 03.08.2006, shifra DPR-90066517 me datë 10.02.2011, shifra DPR-90100126 me datë 10.11.2014 dhe shifra DPR-90127482 me datë 18.12.2017. Bazuar në analizën e procesverbaleve të pranimeve të instalimeve elektrike si dhe procesverbaleve të inspektimit për shifrat DPR – 90042942, DPR – 2003881, DPR-90066517 dhe DPR – 90127482 vërtetohet se të gjithë këta konsumatorë janë regjistruar nga KEK dhe KEDS bazuar në inspektimet e bëra, me kWh të shpenzuar, pra pa kërkesa të konsumatorëve dhe se në asnjë rast nuk është evidentuar se këta konsumatorë kanë marrëveshje me pronarin e asetit privat për kyçje apo që kërkohet nga këta konsumatorë që të marrin leje nga pronari. Bordi i ZRRE po ashtu konstaton se bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga të gjitha palët pronari i asetit në asnjë rast deri me parashtrimin e ankesës/kërkesës në KEDS me datë 30.12.2022 nuk ka kundërshtuar kyçjen si dhe furnizimin e këtyre konsumatorëve përmes TS të tij.

Bordi i ZRRE po ashtu gjen se DMK duke marrë për bazë se në Aneksin për Pëlqimin Parimor me nr. 969 datë 11.10.2004 tek kushtet e përcaktuara Financiare pika 4 po ashtu është evidentuar se: pas pranimit teknik, komisioni investitor duhet të bëjë kontratën me Divizionin e Rrjetit për pronësinë e objektit TS 10(20)/0.4 kV dhe linjës kabllorike 10(20) kV si dhe duke marrë për bazë të dhënat të cilat KEDS i ka dërguar në ZRRE për vitin 2023 ky TS figuron në pronësi të KEDS, kurse në të dhënat e dërguara për vitin 2021-2022 deri në periudhën 12/2021 figuron në pronësi të KEDS pastaj për periudhën 01/2022 deri në periudhën 12/2022 si TS privat, ka kërkuar të dërgohen sqarimet e nevojshme lidhur me pronësinë e TS si dhe ekzistimin apo jo të marrëveshjes për kyçjen e konsumatorëve të tjerë në TS me kod 10012181047. Edhe përkundër kërkesës së DMK-së në ZRRE, Bordi i ZRRE ka vërtetuar se KEDS nuk ka arritur që të ofrojë informatat e kërkuara.

Bordi i ZRRE konstaton se përderisa kyçjet janë bërë nga vet konsumatorët dhe pastaj të njëjtit janë regjistruar nga KEK dhe KEDS këta konsumatorë janë kyçur në kundërshtim me procedurat në fuqi përkatësisht, Metodologjisë së Taksave të Kyçjes së OSSH-së dhe Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji. Bordi i ZRRE duke pasur parasysh faktet e lartë përmendura



dhe kërkon nga KEDS që të beje shqyçjen e konsumatorëve të cilët nuk kanë marrëveshje kyçjeje/furnizimit nga TS me kod 10012181047 me pronarin e asetit dhe se brenda periudhës tranzitor 3 mujore të bëjë zgjidhjen për kyçjen e tyre në asetet e KEDS-it me shpenzime të Operatorit të Sistemit Shpërndarjes.

Bordi i ZRrE po ashtu konstaton se edhe përkundër faktit që konsumatori në përputhje me nenin 6 paragrafit 2 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë ka parashtruar ankesë në KEDS dhe KESCO e ku thuhet se: *2. "Të gjithë konsumatorët të cilët kanë ankesa në lidhje me shërbimet e ofruara nga furnizuesi apo operatorët e sistemit fillimisht duhet t'i paraqesin këto ankesa të furnizuesi përpara se të kërkojnë shqyrtim nga Rregullatori por që të njëjtit nuk kanë lëshuar përgjigjen në ankesën/kërkesën e konsumatorit e që kjo është në kundërshtim me nenin 10 paragrafin 1 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë e ku thuhet se: "Çdo furnizues apo operator i sistemit është i detyruar t'u përgjigjet të gjitha ankesave të konsumatorëve dhe aplikuesve, në mënyrë efektive dhe të drejtë".*

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët PEE nr.03/17 datë 13.01.2004 dhe Aneks për Pëlqim Parimor nr. 969 i datës 11.10.2004, rrjedhën e energjisë elektrike dhe transaksionet e shifrave DPR – 2003881; DPR – 90039450; DPR – 90042942; DPR – 90066517; DPR90100126 dhe DPR – 90127482, procesverbalet e inspektimit dhe regjistrimit për shifrat DPR – 90042942, DPR – 2003881, DPR-90066517 dhe DPR – 90127482, Metodologjisë së Taksave të Kyçjes të Rrjetit të Shpërndarjes, Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Arta Isufi, anëtare

Adnan Preniqi, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KEDS,
- Aplikuesit: **XH.K "INTEREX"** dhe
- Arkivit të ZRRE-së.